



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tipologji tekstore (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; leksione - ; seminare 40 orë;

Viti / Semestri: Viti II/ semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda "Tipologji tekstore" (moduli 2) synon aftësimin e studentëve për të kuptuar një tekst dhe për të shkëputur idetë kryesore të tij. Kjo analizë është e rëndësishme sepse i mundëson studentit të japë gjykimin mbi një tekst, një ide, mendim, etj. Tipologjia tekstore konceptohet me ushtrime që konsistojnë në analizën e teksteve autentike.

Objektivat specifike lëndore:

1. Lënda "Tipologji tekstore" (2) ka si qëllim t'i pajisë studentët me njohuri rreth strukturës sintaksore të gjuhës ruse, njësive sintaksore, llojeve të lidhjeve sintaksore; rreth strukturës, semantikës dhe funksionimit të togfjalëshit, të fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë;
2. Të zhvillojë shprehinë e përdorimit të lirshëm të mjeteve ligjërimore;

Rezultate të pritshme :

1. Të përcaktojë, në tërësinë e teksteve letrare ose jo letrare, grupimet tipologjike të tyre : përshkrimin, tregimin, shpjegimin, informimin, argumentimin ;
2. Të kuptojë përmbajtjen e tekstit dhe të hartojnë planin e tij .
3. Në përgjithësi, studenti ftohet të zhvillojë kulturën e tij të përgjithshme dhe të ushtrojë një reflektim kritik.
4. Metodologjia e lëndës është konceptuar si një analizë në ndihmë të mësimdhënies dhe të nxënit të gjuhës.